



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR I SHTETIT PËR STANDARDET E SHËRBIMEVE

Nr. 6483 prot.

Tiranë, më 22.11.2022

Lënda: Mbi procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024

**MINISTRISË SË DREJTËSISË**

**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**MINISTRISË SË BRENDSHME**

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

**MINISTRISË PËR INFRASTRUKTURËN DHE ENERGJINË**

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT**

**MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT**

**MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

**MINISTRISË SË KULTURËS**

**MINISTRISË SË MBROJTJES**

**MINISTRI I SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN**

**MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT**

**MINISTRI I SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES**

**AGJENSISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

**AGJENSISË PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE**

Të nderuar,

Shqipëria është pjesë e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership- OGP) dhe në këtë kuadër me qëllim nxitjen dhe bashkërendimin e nismave konkrete në mbështetje të parimeve të hapjes, transparencës, gjithëpërfshirjes dhe promovimit të vlerave të qeverisjes, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 145, datë 20.12.2021 “*Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur*” është krijuar Komiteti Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 177, datë 28.10.2022, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve është emëruar si Bashkëkryetar i këtij Komiteti. Ju informojmë që ka nisur procesi për hartimin e **Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024**.

Institucionet tuaja mund të japin propozimet dhe idetë, sipas fushës suaj të përgjegjësisë, propozime të cilat, pasi të shqyrtohen teknikisht, mund të kthehen në angazhime që do të përfshihen në Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024.

Në mbledhjen e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur, përfaqësues të shoqërisë bënë kërkesën për caktimin e një pikë kontakti në ministritë e linjës për mbajtjen e marrëdhënieve/komunikimit me shoqërinë civile, si edhe për OGP.

Për sa më sipër, lutem dërgimin e **propozimeve** në lidhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024, si dhe emrin dhe kontaktet e personit caktuar në institucionin tuaj si **pikë kontakti për OGP**, me shkresë, si edhe elektronikisht në adresat e e-mail-it: [Evis.Qaja@kryeministria.al](mailto:Evis.Qaja@kryeministria.al) dhe [Edlira.Zyfi@kryeministria.al](mailto:Edlira.Zyfi@kryeministria.al), brenda datës **30.11.2022**.

Bashkëlidhur lutem gjeni:

- Urdhrin e Kryeministrit nr. 145, datë 20.12.2021 “*Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur*”;

Urdhrin e Kryeministrit nr. 177, datë 28.10.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin e Kryeministrit nr. 145, datë 20.12.2021 "Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur";

- Udhëzuesin: Procedurat për zbatim në përputhje me rregulloren e OGP-së për hartimin e Planit të Veprimit 2022-2024 'Për Partneritet & Qeverisje të Hapur';

- Udhëzuesin: Kalendarin metodologjik i procesit të finalizimit të Planit të Veprimit 2022 - 2024 'Për Partneritet & Qeverisje të Hapur';

- Udhëzuesin: Për hartimin metodologjik dhe strukturor të Planit të Veprimit 2022 - 2024 'Për Partneritet & Qeverisje të Hapur';

- Udhëzuesi: Formatet strukturore për inpute dhe kontribute nga institucionet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje,

**MILVA EKONOMI**

**MINISTËR**

